



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 21/2016**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Rafet Haxhaj dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Partia Popullore e Malazezëve të Kosovës (NCPK), paraqitur kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ me nr. protokolli 219-2016 të datës 16.03.2016, përshkak të çregjistrimit të po të njejtit subjekt politik, në seancën e panelit të mbajtur me 21.03.2016, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i subjektit politik Partia Popullore e Malazezëve të Kosovës (NCPK).

### Arsyetim

Me datë 17.03.2016 PZAP-i, ka pranuar një apel nga subjekti politik NCPK, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër protokolli 219-2016 të datës 16.03.2016 për shkak të çregjistrimit të po të njejtit subjekt nga regjistri i partive politike.

Parashtruesi i apelit thekson se për shkak të obligimeve që kanë pasur jashtë territorit të Kosovës gjatë periudhës prej 10 janar të këtij viti, dhe nuk kanë pasur mundësi që të dorëzojnë formularët e nevojshëm që sipas tyre nuk ka paraqitur ndonjë problem që ti plotësojnë dhe ti dorëzojnë, por nga mungesa e kryetarit të subjektit politik NCPK formularët nuk kanë mundur të nënshkruhen.

Me këtë rast parashtruesi i apelit kërkon që të rishikohet vendimi i KQZ-së, që Partia Popullore e Malazezëve të Kosovës (NCPK) të kthehet në regjistrin e partive politike.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në, për apelin që është bërë ndaj vendimit të saj dhe ka kërkuar që të ofroj përgjigjen në apel deri më datë 21.03.2016, në ora 09:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i mori përgjigjen e kërkuar nga KQZ, në të cilën theksohet se duke u bazuar në nenin 63.4 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), nenit 8.1 pika e) e Rregullës nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, për shkak të mos përmbushjes së obligimeve që dalin nga neni 11 i Rregullës 01/2013, për dorëzimin e të dhënave të ndryshuara vjetore me që

afati i fundit ishte 31.01.2016, ka çregjistruar subjektin politik Partia Popullore e Malazezëve të Kosovës (NCPK).

NCPK edhe përkundër Njoftimit të bërë nga ZRPPC-ja më 11 janar 2016, dhe Njoftimit të dytë të datës 15 shkurt 2016, për afat shtesë edhe për 20 ditë nga ana e KQZ-së, nuk e ka respektuar afatin ligjor dhe nuk e ka dorëzuar ndryshimin e të dhënave të subjektit politik.

KQZ, në përgjigjen e saj si dëshmi ka bashkangjitur:

- Shkresa nga Zyra me datë 11.01.2016,
- Vendimin e KQZ-së për pezullimin e Partisë Politike NCPK të datës 08.02.2016,
- Njoftimin e bërë përmes email-it të ri përsëritur të datës 15.02.2016,
- Shkresa e datës 25.02.2016,
- Vendimin e KQZ-së për Çregjistrim të datës 16.03.2016,
- Njoftimin për të drejtën në ankesë brenda afatit 24 orë në PZAP.

PZAP-i pasi që shqyrtoj apelin dhe shkresat e lëndës gjeti se:

### **apeli është i pabazuar**

Dispozita e nenit 8.1 e Rregullës nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, për mos përmbushjen e obligimeve që dalin nga neni 11 i kësaj rregulle, që parasheh që Partia e regjistruar politike i kompletton dhe ia dorëzon Zyrës të dhënat e ndryshuara vjetore deri më 31 janar të çdo viti duke identifikuar të dhënat e ndryshuara të subjektit.

Me këtë rast subjekti politik NCPK përkundër obligimit ligjor për dorëzimin e ndryshimit të të dhënave, përkundër paralajmërimeve të bëra nga ZRPPC si dhe pas Vendimit nr. 108/2016 të datës 08.02.2016 të marrë nga ana e KQZ-së, për pezullimin e partisë politike nga regjistri i partive, me ç'rast iu kishte shtuar afati edhe për 20 ditë ajo përsëri nuk e ka dorëzuar ndryshimin e të dhënave vjetore ashtu siç ka qenë i obliguar ta bëjë deri me datën 31 janar përkatësisht 20 shkurt 2016.

Andaj me këtë rast nga të gjitha ato që u theksuan më lart PZAP-i, konstaton se vendimi me nr. 219-2016 të datës 16.03.2016 i KQZ-së, është i drejt dhe i bazuar në ligj, prandaj pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara dhe në mbështetje të nenit 115.1 lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 21/2016 më datën 21.03.2016

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i pranimit të vendimit të PZAP-it.

